

VENDIM
Nr.57, datë 21.1.2009

PËR HAPJEN E FILIALIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE
“KRISTAL” NË QYTETIN E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në qytetin e Korçës, të filialit të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Sociale, të Fakultetit të Drejtësisë dhe atij të Infermierisë, si pjesë përbërëse të shkollës së lartë universitare, private “Kristal”, me seli në Tiranë, në programet e studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

- a) Drejtësi;
- b) Infermieri;
- c) Administrim Publik;
- ç) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- d) Shkenca komunikimi.

2. Këto programe studimi do të jenë të njëjta me programet e studimit, që shkolla e lartë universitare private “Kristal”, ofron, përkatësisht, në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Sociale, në Fakultetin e Drejtësisë dhe në atë të infermierisë, në selinë qendrore të saj, në Tiranë. Ato do të realizohen, përkatësisht, me 180 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushat e arsimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Kristal”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Kristal”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Filiali i shkollës së lartë universitare private “Kristal” në Korçë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha